



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË – SHKOLLA E MESME

31 tetor 2020

Faza e tretë

Përgjigje 1

(4 pikë)

Humanizmi ishte një mënyrë të menduari dhe të vepruari që bazohej mbi vlerën dhe dinjitetin njerëzor, në vend të besimit fetar. Rilindja ishte një lëvizje kulturore evropiane, që zuri fill në fund të mesjetës e deri në epokën moderne (gjysma e shek.XV deri në gjysmën e shek.XVI).

Qytet – shtetet italiane:

- kishin një pozitë gjeografike të favorshme në Gadishullin Apenin.
- kishin një numër të lartë të popullsisë.
- fituan pavarësinë dhe lulëzuan falë tregtisë mes Lindjes e Perëndimit.
- duke u mbështetur tek e Drejta Romake, krijuan ligje për rendin, për zhvillimin ekonomik e politik brenda këtyre qytet-shteteve.

Faktorë të tjerë:

- zhvillimi i rrugëve, krijimi i bankave.
- zhvillimi u shoqërua me rritjen e dashurisë së qytetarëve për qytetet e tyre. Makiaveli shkruante: “Unë e dua qytetin tim të lindjes më shumë se shpirtin tim”.

Përgjigje 2 (a)

(2 pikë)

Lëvizjet për liri e pavarësi, si dhe fuqizimi i ndjenjave kombëtare kishin nisur që në periudhën e pushtimeve të Napoleon Bonapartit, kur popujt e pushtuar filluan të kundërshtonin pushtimin francez; kjo ndjenjë u forcua me tej pas kongresit të Vjenës, në vitin 1815, kur kufijtë u ndanë sipas interesave të shteteve fituese dhe shumë popuj mbetën të copëtuar (populli gjerman dhe ai italian) ose nën sundimin e perandorive shumëkombëshe (Perandoria Austriake, Perandoria Ruse dhe ajo Osmane).

Në vendin tonë nacionalizmi nisi në periudhën e Rilindjes kombëtare shqiptare, ku dy dokumentet kryesore të nacionalizmit shqiptar janë veprat “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, e Pashko Vasës dhe “Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe çdo të bëhet”, e Sami Frashërit.

Përgjigje 2 (b)

(4 pikë)

Dallimi mes nacionalizmit dhe nacionalizmit ekstrem mbeshetet në ngjarje të tilla si:

- bashkimi i Gjermanisë nën drejtimin e Prusisë dhe Oto fon Bismarkut.
- bashkimi i Italisë nën drejtimin e Mbretërisë të Piemontit, si dhe lufta për çlirimin e Jugut nën drejtimin e Xhuzepe Garibaldit.
- rritja e nacionalizmit dhe nacionalizmit ekstrem për shkak të luftës së parë botërore.
- ndikimi i nacionalizmit ekstrem në ideologjitë fashiste dhe naziste, që çoi në fillimin e konfliktit të dytë botëror.
- hartimi dhe zbatimi i përmbajtjes dhe platformave të nacionalizmit grek dhe serb, si “Megali Idea” dhe “Naçertania”
- kushtet në të cilat lindi nacionalizmi shqiptar gjatë periudhës së “Rilindjes kombëtare”.

Përgjigje 3 (a)**(4 pikë)***Faktet historike më të rëndësishme janë:*

- mbretëria Ilire gjatë dinastisë së Enkelejve dhe Taulantëve, në konflikt me Maqedoninë.
- dardanët në konflikt me Maqedoninë për krahinën e Pajonisë.
- Pirroja i Epirit në luftë me Argosin dhe Spartën.
- mbretëresha Teuta pushtoi Korkyrën. Mbreti Agron luftoi në Etoli dhe Epir.
- sulmet bullgare dhe serbe në tokat arbërore shekulli XI-XIII.
- pushtimi i territoreve Arbërore nga Stefan Dushani shekulli XIV etj.
- pushtimet e Mahmut Pashë Bushatlliu në krahinat e Bosnjës dhe Malit të Zi.
- projektet nacionaliste si Naçertania dhe Megali Idea.
- zgjerimi në territoret shqiptare i shteteve, si: Mali i Zi, Serbia, Greqia, pas Kongresit të Berlinit në 1878.
- luftërat ballkanike dhe synimi për copëtim i trojeve shqiptare.
- copëtimi i shtetit shqiptar në 1913 dhe përfitimi i fqinjëve ballkanikë nga këto territore, gjë që është një nga arsytet që ende të kete situata konfliktuale (p.sh mos njohja e shtetit të Kosovës nga shteti serb)..., etj.

Përgjigje 3 (b)**(4 pikë)**

Armiqtë e përbashkët të popujve të Ballkanit ndër shekuj dëshmohen nga përballjet e këtyre popujve me sulmet Kelte, Romake, Bizantine dhe Osmane.

Aleancat e ngritura në këto kushte ishin:

- aleanca e dardanëve me maqedonasit kundër sulmeve kelte.
- tri koalicionet ballkanike kundër perandorisë Osmane në shekullin XIV.
- ndihma që dhanë shqiptarët dhe Ali Pashë Tepelena në revolucionin grek.
- krijimi i "Konfederatës Ballkanike" nga Mahmut Pashë Bushatlliu etj...

Përgjigje 4 (a)**(2 pikë)***Kuptimet:*

Pronjë – pronë e kushtëzuar, në përdorim të zotëruesit, i cili e administronte në këmbim të kushteve të parapërcaktuara nga pronari i përhershëm i saj, shteti bizant.

Bashtinë - pronë e pakushtëzuar; pronari kishte të drejtë të plotë, ta ndante, ta linte Trashëgimi apo ta shiste.

Përgjigje 4(b)**(4 pikë)**

Për të shpjeguar këtë çështje, në fillim sqarojmë çfarë është sistemi feudal. Sistemi feudal ishte ai sistem që sillte forcimin e pozitave të pronarëve të mëdhenj të tokave dhe krijonte hapësirë për t'iu shmangur detyrimeve nga pushteti qendror.

Ndikimet:

- në shek.XIII- XVI, pushteti perandorak kishte filluar të humbiste fuqinë e tij dhe kjo u duk kur pronjat filluan të ktheheshin në feud.
- ky fuqizim ekonomik, politik e juridik u shfaq ndaj fshatarit dhe pushtetit qendror.
- pronarët kishin të drejtë të shitblerjes së pronës dhe të trashëgimisë së saj.
- patrikët u kthyen në bujq që merrnin tokën me qira, në detyrim në natyrë, pagesa në të holla ose punë angari, kjo solli bujkrobërimin e plotë për bujkun.
- në planin juridik, fisnikët-pronarë fituan të drejta absolute mbi zotërimet e tyre, kështu fisnikët u shndërruan në feudalë të pavarur nga pushteti qendror.

Përgjigje 5 (a)**(4 pikë)**

Përgjigjja e plotë lidhet me shpjegimin që do t'u bëhet katër momenteve të mëposhtme.

- Sulmet sllave goditën brezin perendimor të trevave iliro- shqiptare. Fiset avaro-sllave ndoqën rrugën përgjatë Danubit drejt jugut të Ballkanit, duke goditur që nga Selaniku e deri në Peleponez.
- Sulmi më i fuqishëm ishte ai i vitit 609 kur u shkretua Maqedonia, Thesalia e Peloponezi. Nga Maqedonia grupet sllave ndoqën luginat e Devollit e Osumit.
- Në bregdetin dalmat, që nga gryka e Kotorrit e më sipër u vendosën fiset sllave të trebinjëve, kanavlitëve, zaklumëve dhe narentinëve.
- Në Shek. VII, perandori Heraklit lejoi dy fise sllavësh, kroatët dhe serbët, që të vendoseshin në Ballkan me qendër krahinën e Rashës.

Përgjigje 5 (b)**(4 pikë)**

Në Ilirinë e Jugut, pra në Prevali, në Dardani, në Epirin e Vjetër dhe në Epirin e Ri, popullsia i bëri ballë asimilim sllav, sepse:

- Iliria e Jugut ishte zona me një zhvillim ekonomik më të lartë së pjesa tjetër, nga ku kalonin rrugët më të rëndësishme tregtare.
- në këto zona kemi dendësinë më të madhe të popullsisë, që kishte krijuar nivel të lartë kulturor duke ngritur formacionet e para shtetërore ilire.
- fortifikimet bregdetare dhe barrierat e relievit malor ishin pengesë për depërtimin e sllavëve.
- sllavët në Ilirinë e Jugut mbetën të izoluar dhe ata u asimiluan gjatë kohës.
- dyndjet sllave sollën dobësimin e sundimit bizant, kështu pushtetin në qytetet e mëdha e morën forcat lokale dhe në krahinat e brendshme u ruajt autonomia dhe e drejta zakonore.

Përgjigje 6 (a)**(4 pikë)**

- Xhon Loku – sipas tij njeriu ka tri të drejta natyrore: të drejtën për të jetuar, të drejtën për të qenë i lirë dhe të drejtën për të pasur pronë.
- Monteskiei -- duke u mbështetur në monarkinë kushtetuese angleze theksoi ndarjen e pushteteve në: legjislativ, me bazë parlamentin; ekzekutiv, si zbatues i ligjeve dhe gjygjësor, si garant i zbatimit të ligjeve.
- Rusoi – teoria e “demokraciasë së drejtpërdrejtë”
- Volteri – modernizimi i mënyrës së qeverisjes me synim rritjen e mirëqenies së popullit.

Përgjigje 6 (b)**(4 pikë)**

Faktorët lidhen me zhvillimin e mendimit filozofik të kohës. Në bazën e argumentit iluminist ishte arsyeja dhe kritika ndaj së kaluarës mesjetare, e cilësuar si epoka e errët e historisë. Arsyja dhe vertetësia shkencore janë elementë kryesorë që e qartësojnë njeriun dhe jo fanatizmi, padituritë, paragjykimet, mungesa e lirisë.

Iluministët argumentuan idetë e tyre se burimi i pushtetit nuk duhet të vijë nga Zoti, por nga populli me anë të barazisë së shtresave shoqërore, të drejtës për të qenë i lirë e pasur pronë.

Këto bënë që monarkitë absolute të hartojnë ligje tiranike, prandaj duhej të emancipoheshin monarkitë dhe të demokratizoheshin ato nëpërmjet rritjes së rolit të parlamentit; u ndërmorën reforma për modernizimin e shtetit, zhvillimin e ekonomisë dhe bujqësisë me synim rritjen e mirëqenies së popullit.

Përgjigje 6 (c)

(2 pikë)

Ndikimet e iluministëve:

- iluministët ndikuan në disa nga monarkitë evropiane, Frederiku II i Prusisë, Maria Tereza e Austrisë, Pjetri I dhe Katerina II e Rusisë.
- iluministët ndërmorën reforma qeverisëse, si modernizimi i ekonomisë, përhapja e arsimit, liria fetare, kufizimi deri në heqje të privilegjeve të shtersave të pasura.
- monarkët realizuan dhe reforma administrative.
- këto reforma sollën jo vetëm zhvillimin e këtyre monarkive, por edhe zgjerimin e territoreve, si në rastin e Prusisë dhe Rusisë që doli në detin e Zi.

Përgjigje 7

(8 pikë)

2 pikë nëse nxënësi shkruan një ese të strukturuar në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- të tregojë një të kuptuar të qartë/plotë të temës/problematikës.
- të zhvillojë të gjitha aspektet e temës/problematikës, madje edhe në thellësi.
- të jetë më shumë analizues sesa përshkrues.
- të mbështetet në të paktën **3 fakte konkrete**, shembuj specifikë dhe detaje.
- të demonstrojë një organizim logjik të argumentimit të temës.

3 pikë nëse nxënësi evidenton të paktën **tri** nga faktorët e mëposhtëm, që çuan në reformat protestane.

Faktorët që çuan në reformën protestane:

- Në përfundim të Mesjetës, shtetet monarkike të sapolindura në Francë, në Angli e Spanjë filluan të sfidojnë pushtetin papal.
- Priftërinjtë ishin më shumë të interesuar për para sesa për rënjosjen e besimit fetar katolik.
- Indulgjencat (nxënësit duhet të shpjegojnë çfarë janë)
- Pakënaqësitë nga ndërhyrjet e klerikëve në punët e brendshme të shteteve evropiane dhe për shkak të taksave të shumta.

3 pikë nëse nxënësi evidenton të paktën **3** prej ngjarjeve kryesore (politike/fetare) që ndodhën nga reformat protestan.

Ngjarjet kryesore janë:

Protestanizmi ishte një lëvizje që shënoi një kthesë të rëndësishme në zhvillimet e mëvonshme në Evropë në fushën politike/ fetare.(mund të komentohet më gjerë nga nxënësit)

Në fushën politike

- Në vitin 1555, Perandori Karli V, vendosi paqe me Augsburgët (për shkak të kryengritjeve), kështu ai u detyrua të pranonte parimin e lirisë fetare.
- U përhap shpejt ndër klasat borgjeze të vendeve, si: Zvicër, Holandë dhe Francë, që ndikoi në vendimet politike të këtyre shteteve, si ndarja nga ndikimi i pushtetit papal.
- Në Angli, Henri VIII, në vitin 1533 mohoi pushtetin papal, duke e shoqëruar në vitin 1534 me ligjin ku mbreti i Anglisë ishte edhe kryetar i kishës anglikane.

Në fushën fetare

- Korrupsioni në fenë katolike.
 - Feja shihej e distancuar nga populli, kurse protestanët ishin më pranë popullit me idete e tyre, siç janë: përkthimi i biblës, heqja e indulgjencave; interpretimi i biblës nuk duhej të bëhej vetëm nga priftërinjtë; njeriu duhej t'i lutej vetë Zotit dhe Papa s'kishte pse të ishte ndërmjetësues.
- Liberalizimi i protestantizmit pasqyroi edhe rilindjen e kohës, si zhvillimi dhe përhapja e shtypit, që dhanë një ndihmesë në përhapjen e ideve të reja